




Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61 paragrafi 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1. nënparagrafi d) si dhe nenin 63 paragrafin 63.1.1. nënparagrafi a) të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "G.I. Grafo Loni" Sh.P.K. të datës 28.04.2023 kundër njoftimit mbi vendimin e autoritetit kontraktues të datës 25.04.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizimi me pajisje rekuizita sportive dhe pajisje të tjera për IEAA" me nr. të prokurimit 616-23-1280-1-2-1 dhe me nr. të brendshëm 616 23 037 121, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "G.I. Grafo Loni" Sh.P.K. e datës 28.04.2023 kundër njoftimit mbi vendimin e autoritetit kontraktues të datës 25.04.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizimi me pajisje rekuizita sportive dhe pajisje të tjera për IEAA" me nr. të prokurimit 616-23-1280-1-2-1 dhe me nr. të brendshëm 616 23 037 121.
- II. **AUTORIZOHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit të përcaktuar si në pikën I të këtij vendimi. Autoriteti Kontraktues, për nënshkrim të kontratës, duhet të pres se paku 10 ditë kalendarike me efekt nga dita pas datës në të cilën autoriteti kontraktues ka marrë këtë vendim.
- III. **NJOFTOHET** operatori ekonomik "G.I. Grafo Loni" Sh.P.K. si dhe të gjitha palët tjera të interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik "G.I. Grafo Loni" Sh.P.K. (tutje "parashtruesi") me datë 28.04.2023 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin e autoritetit kontraktues të datës 25.04.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizimi me pajisje rekuizita sportive dhe pajisje të tjera për IEAA" me nr. të prokurimit 616-23-1280-1-2-1 dhe me nr. të brendshëm 616 23 037 121.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin merit (in meritum) të kërkesës.

Pretendimet e parashtruesit janë si në vijim:

Pretendimi i parë (I) - Komisioni i vlerësimit ka shpallur si fitues OE më të shtrejtë (sesa parashtruesi).

Pretendimi i dytë (II) - parashtruesi nuk pajtohet me faktin se komisioni i vlerësimit përmes raportit të vlerësimit ka gjetur se parashtruesi nuk i ka plotësuar kërkesat teknike dhe profesionale sipas dosjes së tenderit.

Për shkak të pretendimeve si më sipër, parashtruesi konsideron se autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës në këtë aktivitet të prokurimit ka vepruar në kundërshtim me nenin 1, 7, 59 dhe 60 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik (tutje "LPP").

Pas njoftimit për zgjatje të afatit për shqyrtimin e kërkesës për rishqyrtim në përputhje me nenin 61 paragrafin 61.3. të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik (tutje "RRPP"), autoriteti Kontraktues - Komuna e Prishtinës përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit me datë 04.05.2023 ka trajtuar kërkesën e parashtruesit për rishqyrtim. Pas analizimit të pretendimeve të parashtruesit është gjetur se pretendimet e parashtruesit janë të bazuara në kuptim të nenit 63 paragrafit 63.1. nën paragrafi 63.1.2. të RRPP.

Për shqyrtimin e pretendimit të parashtruesit, janë administruar këto prova materiale:

- B05 Njoftimi për kontratë i dt. 22.02.2023.
- Dosja e tenderit e dt. 23.02.2023.
- Oferta e parashtruesit.
- B12 Procesverbali i hapjes së tenderëve i dt. 23.03.2023.
- Raporti i vlerësimit të tenderëve i dt. 24.04.2023.
- B47 Letra standarde për sqarimin e tenderit të dt. 04.04.2023.
- Përgjigja në B47 Letrën standarde për sqarimin e tenderit të dt. 06.04.2023.
- B58 Njoftimi mbi vendimin e autoritetit kontraktues i datës 25.04.2023.
- Letra standarde për tenderuesin e eliminuar të datës 25.04.2023.

Pas trajtimit të kërkesës për rishqyrtim është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme dhe nuk ka dorëzuar dëshmi të mjaftueshme për të vërtetuar pretendimet e tij. Po ashtu nga provat e administruara nuk është arritur që të vërtetohen pretendimet e parashtruesit sipas nenit 62 paragrafit 62.1 nënparagrafi d) të RRPP.

Lidhur me pretendimin e parë duhet cekur se sipas nenit 60 paragrafit 1 nënparagrafit 1 përcaktohet se *“Autoriteti kontraktues do t’ia jap kontratën publike operatorit ekonomik që ka dorëzuar tenderin e përgjegjshëm me çmimin më të ulët”*. Në rastin konkret tenderuesi që është rekomanduar për dhënie të kontratës përmes raportit të komisionit vlerësues është gjetur se ka qenë **tenderi i përgjegjshëm** me çmimin më të ulët. Fakti që ka pasur tender të papërgjegjshëm me çmim më të ulët nuk përbën shkelje të nenit 1 të LPP sikurse pretendohet nga parashtruesi. Prandaj pretendimi i parë i parashtruesit është i pabazuar.

- **Lidhur me pretendimin e dytë** fillimisht duhet cekur se përmes dosjes së tenderit në kuadër të kapacitetit teknik dhe profesional (kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1&9.2) është përcaktuar se *“OE duhet të ofroj dëshmi se ka realizuar furnizime të ngjashme në tri vitet e fundit (duke filluar nga data e publikimit të njoftimit për kontratë) në vlerën prej 75,000.00 Euro”*. Dëshmia dokumentare që është kërkuar në këtë rast është *“Një listë të kontratave të realizuara duke plotësuar ankesin 6 të dosjes së tenderit ku duhet saktësuar titullin e kontratës, shumën e kontratës, datën e fillimit dhe datën e përfundimit dhe përfituesin, si dhe listës t’i bashkangjiten referencat ose çertifikatat për kryerje të furnizimeve”*.

Lidhur me këtë kriter autoriteti kontraktues me datë 04.04.2023 ka dërguar te parashtruesi B47 Letrën standarde për sqarimin e tenderit ashtu që i ka bërë me dije parashtruesit se nuk ka dorëzuar referencat ose çertifikatat lidhur me kontratat në aneksin 6 sikurse kërkohet me dosjen e tenderit dhe njëkohësisht ka kërkuar që të dëshmoj para autoritetit kontraktues nëse e plotëson këtë kriter të dosjes së tenderit. Me datë 06.04.2023 parashtruesi ka dërguar një përgjigje në këtë kërkesë të autoritetit kontraktues. Tutje komisioni vlerësues ka ekzaminuar dhe vlerësuar ofertën e tenderit së bashku me përgjigjen e ofruar me datë 06.04.2023 dhe ka konstatuar se parashtruesi nuk e plotëson kriterin në fjalë të dosjes së tenderit. Kjo për arsye se një referencë lidhur me Komunën e Prishtinës i referohet një aktiviteti të prokurimit për furnizimin me pajisje për inografike në objektin e komunës dhe si i tillë nuk është aspak i ngjashëm (sikurse kërkohet me DT). Ky fakt nuk është kontestuar as nga parashtruesi në mënyrë specifike në dosjen e tenderit. Tutje komisioni vlerësues ka gjetur se faturat dhe profaturat që ka dorëzuar parashtruesi nuk mund të zëvendësojnë referencat ose çertifikatat të cilat janë kërkuar me dosjen e tenderit. Ky fakt është po ashtu i pakontestueshëm pasi që kriteri në dosjen e tenderit ka qenë mjaft konkret dhe i kuptueshëm. Rrjedhimisht komisioni me të drejtë ka gjetur se parashtruesi nuk e plotëson kriterin e dosjes së tenderit lidhur me kapacitetin teknik dhe profesional. Prandaj edhe pretendimi i dytë i parashtruesit është i pabazuar.



Sipas trajtimit dhe elaborimeve më lartë në këtë vendim është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij. Njëkohësisht nga provat materiale të administruara është gjetur se pretendimet e parashtruesit janë tërësisht të pabazuara. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. nënparagrafin a) lidhur me nenin 62 par. 62.1. nënparagrafin d) të RRPP.

Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të RRPP.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 04.05.2023

Visar SHEHU

Ud. Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës


Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.